**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

**I.GJA.nr.1/2023-68**
**Me datë 23.10.2023**

**KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**RAPORTI PËR PUNËN E GJYKATËS THEMELORE NË PRIZREN DHE DEGËVE TË SAJ NË SUHAREKË DHE DRAGASH PËR TRE MUJORIN E TRETË-të (KORRIK – GUSHT – SHTATOR) 2023**

Në kuptim të nenit 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të Ligjit për Gjykatat, paraqes raportin për tre mujorin e tretë (KORRIK – GUSHT – SHTATOR) 2023.

Marrë në përgjithësi në aspektin e efikasiteti dhe zgjidhjes së lëndëve, Gjykata Themelore në Prizren ka një rritje të efikasitet të zgjidhjes së lëndëve në secilin departament dhe divizion, përjashtimisht në 2 divizione (Kundërvajtjes dhe degën në Dragash). Në tre mujorin e III-të, në krahasim në tre mujorin e II-të, thuajse në secilin divizion ka rritje të efikasitetit dhe rritje të numrit të lëndëve të zgjidhura, ndërsa presim që në tremujorin e fundit të vitit kur edhe puna është më intensive dhe aktive, të ketë rritje të efikasitet dhe të punës në përgjithësi.

Tashmë Gjykata Themelore në Prizren pas një riorganizimi, ka një ritëm jashtëzakonisht të madhë të punës që edhe po ndikon pozitivisht në rezultatin dhe efikasitetin e punës.

Ndër të tjera, si Kryetare e gjykatës në ditë të caktuara organizojmë *"ditën e hapur"* dhe presim në takim qytetarët dhe palët e interesuara, shqetësimet dhe kërkesat e të cilëve i adresojmë dhe i trajtojmë me gjyqtarët dhe stafin mbështetës.

Në tre mujorin e tretë rregullisht kemi pasur takime me gjyqtarët e divizioneve të caktuar, ku me datë 13.10.2023, është mbajtur kolegjiumi i rregullt për tre mujorin e tretë me të gjithë gjyqtarët, ndërsa me datë 16.10.2023 është mbajtur kolegjium i veçantë me gjyqtarët e departamentit për krime të rënda dhe të departamentit për të mitur, me datë 17.10.2023 është mbajtur kolegjium me gjyqtarët e divizionit penal dhe të kundërvajtjes dhe me datë 20.10.2023 është mbajtur kolegjium i veçantë me gjyqtarët e divizionit civil, ku është diskutuar efikasiteti i punës. Gjithashtu, në këto kolegjiume diskutim kryesor kanë qenë dy planet e KGJK-së. Për më tepër të bashkëngjitur i keni procesverbalet nga kolegjiumet e veçanta të mbajtura me secilin divizion veç e veç.

*1.Përmbushja e obligimeve që rrjedhin nga Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 – 2025 dhe Plani strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të Korrupsionit dhe Krimit të organizuar 2022-2024 dhe plotësimi i formularit për lëndët e korrupsionit dhe krimin e organizuar – Trajtimi i lëndëve me prioritet?*

Referuar kësaj pike të diskutimit, ju njoftoj se gjatë tremujorit të III-të të vitit 2023, jemi në fazën ku jemi duke aplikuar dhe zbatuar planet strategjike të KGJK-së, pasi që në periudhën 6 mujore 2023, janë identifikuar dhe përpiluar raporte të veçanta për lëndët që bien në kompetencë të Planeve Strategjike.

Me gjyqtarët e secilit divizion kemi pasur takime të veçanta ku kemi identifikuar detyrat dhe përgjegjësitë nga Planet Strategjike.

Nga secili gjyqtar kemi pranuar raport për lëndët që kanë në punë, duke iu referuar kërkesave dhe detyrave që rrjedhin nga Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi.

Tashmë kemi identifikuar të gjitha lëndët në zyrën e secilit gjyqtar (Civile, Penale dhe Krime të Rënda), të cilat do të kenë fokus të veçantë në trajtimin e tyre konform detyrave nga Planet Strategjike.

Me identifikimin e lëndëve në divizionin civil lidhur me zbatimin e strategjisë për zvogëlimin e numrit të lëndëve të vjetra nga gjyqtarët kemi informata se janë zgjidhur të gjitha lëndët më të vjetra se viti 2010 dhe se numri i lëndëve nga viti 2010 deri 2016 është zvogëluar dukshëm. Prioritet në tre mujorin e katërt do të jetë që këto lëndë të përfundojnë në tërësi.

***Perfomanca e Gjykatës – Departamenteve dhe Divizioneve e shprehur në normë efikasiteti në %***

Në tremujorin e III-të të vitit 2023, në tërësi si gjykatë kemi rezultuar me rritje të efikasitetit, në bazë të përqindjeve në lëndët e pranuar dhe atyre të zgjidhura.

E shprehur dha paraqitur në % norma e efikasiteti është si në vijim:

**Gjykata Themelore Prizren**

**PENALE**
D. Krime të Rënda - Norma e zgjidhjes së lëndëve 124% (26 lëndë të zgjidhura)
(169 aktive/në punë)
D. Mitur - Norma e zgjidhjes së lëndëve 183% (66 lëndë të zgjidhura).
(102 aktive/në punë)
Penale Përgjithshëm – Norma e zgjidhjes së lëndëve 113% (449 lëndë të zgjidhura).
(2,464 aktive/në punë)

**CIVILE**
**Divizioni Civil – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve 98%**
Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 93% (895 Lëndë të zgjidhura)

Jo Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 123% (106 lëndë të zgjidhura)
Përmbarimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 125% (314 Lëndë të zgjidhura)
Kundërvajtje – Norma e zgjidhjes së lëndëve 90 % (534 Lëndë të zgjidhura).

**AKTIVE / NË PUNË**
Kontestimore – 8,447 lëndë
Jo Kontestimore – 845 lëndë
Përmbarimore – 1,726 lëndë
Kundërvajtje – 2,199 lëndë

**Totali i lëndëve aktive:: 15,952 lëndë**

**Shënim:** Referuar lëndëve përmbarimore, nuk përputhen të dhënat e përgjithshme me të dhënat individuale të gjyqtarit.

Sipas raportit të përgjithshëm të gjykatës, figurojnë 1,726 lëndë përmbarimore në pritje, ndërsa gjyqtarit Sami Gashi sipas raportit për gjyqtarë, i figurojnë 238 lëndë në pritje. Mos përputhshmëria e të dhënave sipas sistemit SMIL është 1,488 lëndë, kjo figuron negativisht në të dhënat e përgjithshme për lëndët në pritje për gjykatën, të cilin problem edhe e kemi raportuar në KGJK.

Pos në Departamentin për Krime të Rënda, që ka një rënie prej 8%, në Departamentin për të Mitur dhe Divizionin Penal ka rritje të zgjidhjes së rasteve.

Ndërsa në Divizionin Civil ka një rritje të efikasitetit të zgjidhjes së lëndëve, sidomos lëndët përmbarimore ku qytetarët presin drejtpërdrejt realizimin e një të drejte, pasi që numri i lëndëve aktive ka rënë ndjeshëm, tashmë ka 230 lëndë aktive.

Kjo është rezultat i angazhimit të të gjithë gjyqtarëve në këtë divizion dhe rritjes së numrit të bashkëpunëtoreve dhe ndarjes së punëve në mënyrë të barabartë edhe të bashkëpunëtorëve profesional që angazhohen me gjyqtarët.

Për më tepër bashkëngjitur keni tabelat e ndara në mënyrë specifike trajtimin e lëndëve sipas natyrës.

**Gjykata Themelore Prizren - Dega në Suharekë**

Aktualisht në këtë gjykatë janë 4 gjyqtarë, dy në divizionin civil dhe dy në divizionin penal, kurse për lëndët e divizionit të kundërvajtjes që nga janari i 2023 këto lëndë i trajtojnë gjyqtarët e divizionit penal.

Efikasiteti i shprehur në %.

**Gjykata Themelore – Dega SUHAREKË**

**Divizioni Civil – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve 104%**

Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 52% (113 Lëndë të zgjidhura)
Jo Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 68% (40 lëndë të zgjidhura)
Përmbarimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 238% (164 Lëndë të zgjidhura)
Kundërvajtje – Norma e zgjidhjes së lëndëve 128% (228 Lëndë të zgjidhura).

**AKTIVE / NË PUNË**
Kontestimore – 3.158 lëndë
Jo Kontestimore – 101 lëndë
Përmbarimore – 1,426 lëndë
Kundërvajtje – 963 lëndë

**Divizioni Penal** – Norma e zgjidhjes së lëndëve 76% (78 lëndë të zgjidhura) (511 aktive/në punë)

**Totali i lëndëve aktive: 6159 lëndë**

Në tremujorin e III-të, kjo gjykatë ka arritur të zvogëloj numrin e lëndëve aktive sidomos në divizionin civil dhe ka treguar rritje të efikasitetit në krahasim me tremujorin e II-të.

Mirëpo, shqetësuese mbetet numri i vogël i gjyqtarëve, sepse dy (2) gjyqtarë në divizionin civil kanë shumë ngarkesë, nga 1,400 deri në 1,600 lëndë aktive.

Gjyqtari mbikëqyrës i kësaj gjykate Selajdin Gallapeni pret në takim palët dhe personat e interesuar, ku ankesat dhe kërkesat e të cilëve i adreson te gjyqtarët.

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë përballet me mungesë të gjyqtarëve aktualisht, për shkak të pensionimit dhe mos përmbushjes të numrit të gjyqtarëve, si dhe me mungesë të stafit administrativ, referentë, roje sigurimi, dorëzues dhe pozita të tjera të cilat shfaqin pengesa në arritjen e synimeve dhe përmbushjen e të gjitha detyrave me kohë.

**Gjykata Themelore Prizren - Dega në Dragash**

Në këtë gjykatë funksionojnë gjyqtari mbikëqyrës i cili njëkohësisht punon edhe në Gjykatën Themelore në Prizren, kurse në degën në Dragash është i angazhuar në divizionin penal si dhe një gjyqtare e cila është e angazhuar në të gjitha lëmitë.

Efikasitet i shprehur në %.

Gjykata Themelore Prizren – **Dega DRAGASH**

**Divizioni Civil – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve 80%**
Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 20% (17 Lëndë të zgjidhura)
Jo Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 71% (78 lëndë të zgjidhura)
Përmbarimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 1125% (45 Lëndë të zgjidhura)
Kundërvajtje – Norma e zgjidhjes së lëndëve 116% (36 Lëndë të zgjidhura).

**AKTIVE / NË PUNË**
Kontestimore – 1,225 lëndë
Jo Kontestimore – 78 lëndë
Përmbarimroe - 428 lëndë
Kundërvajtje – 112 lëndë

**Divizioni Penal** – Norma e zgjidhjes së lëndëve 32% (11 lëndë të zgjidhura) (398 aktive/në punë)

**Totali i lëndëve aktive: 2,241 lëndë**

Për më tepër bashkëngjitur gjeni raportet në tabela të veçanta.

## RAPORTI PËR MOSHËN E LËNDËVE NË PRITJE

Në bazë të të dhënave të përpunuara nga sistemi SMIL po ju paraqesim gjendjen me lëndë aktive në Departamente dhe Divizione deri më 30 shtator 2023 dhe për moshën e lëndëve në pritje më të vjetra se dy vite (24 muaj) të cilat edhe janë prioritet i Planeve dhe Strategjive të KGJK për efikasitet dhe qasje në Drejtësi.

Gjykata Themelore në Prizren, në fund të shtatorit 2023, ka lëndë në pritje si në vijim:

### PENALE

**Divizioni Penal** – 2,464 lëndë nga ky numër 818 lëndë më të vjetra se dy vite.
**Departamenti për Krime të Rënda** - janë 169 lëndë në pritje, nga ky numër 42 lëndë më të vjetra se dy vite.
**Departamenti për të Mitur** – 102 lëndë në pritje, 59 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 Muaj).

### CIVILE

**Kontestimore** – janë 8,447 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 2,514 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).
**Jo Kontestimore** – janë 845 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 592 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).
**Përmbarimore** – sipas sistemit SMIL janë 1,726 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 414 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).
***Ky numër nuk është i saktë, në bazë të raporti individual të gjyqtarit përmbarues tek i cili figurojnë 238 lëndë aktive.**
**Kundërvajtje** – janë 2,199 lëndë aktive/në punë, nga ky numër 239 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).

**Gjykata Themelore Prizren – DEGA NË SUHAREKË**

**PENALE**

**Divizioni Penal** – janë 511 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 159 lëndë më të vjetra se 2 vite.

**CIVILE**

**Kontestimore** – janë 3,158 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 1,002 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).
**Jo Kontestimore** – janë 101 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 26 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).
**Përmbarimore** – janë 1,426 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 187 lëndë më të vjetra se 2 vite.
**Kundërvajtje** – janë 963 lëndë aktive/në punë, nga ky numër 116 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).

**Gjykata Themelore Prizren – DEGA NË DRAGASH**

**PENALE**

**Divizioni Penal** – janë 298 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 58 lëndë më të vjetra se 2 vite.

**CIVILE**

**Kontestimore** – janë 1,225 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 153 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).
**Jo Kontestimore** – janë 78 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 27 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).
**Përmbarimore** – janë 408 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 29 lëndë më të vjetra se 2 vite.
**Kundërvajtje** – janë 112 lëndë aktive/në punë, nga ky numër 15 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).

***2. Raportim për publikim të vendimeve;***

Publikimi i vendimeve gjyqësore tashmë është një detyrë dhe obligimi ligjor, të cilin Gjykata Themelore në Prizren e përmbush në harmoni me Udhëzimet Administrative.

Gjatë periudhës Korrik – Gusht – Shtator, janë publikuar 1,090 vendime gjyqësore.

Gjykata Themelore Prizren – Dega në Dragash, 29 vendime.

Gjykata Themelore Prizren – Dega në Suharekë, 118 vendime.

Mesatarisht Gjykata Themelore në Prizren publikon ndërmjet 350-450 vendime në muaj, varësisht nga efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve.

Përpos vendimeve për rastet që trajtohen, gjykata vazhdon ti publikoj brenda afatit ligjor edhe vendimet për rastet disiplinore që trajtohen nga Autoriteti Kompetent.

*3. Referimi i rasteve gjyqësore në ndërmjetësim;*

Gjatë tremujorit të III-të të vitit 2023 janë referuar për zgjidhje në Zyrën e Ndërmjetësimit 103 lëndë, ku 72 lëndë janë zgjidhur përmes ndërmjetësimit, prej tyre 49 lëndë të lëmisë penale dhe 23 lëndë të lëmisë civile, ndërsa për 31 lëndë nuk është arritur marrëveshje e ndërmjetësimit, si dhe rastet e tjera janë ende në shqyrtim.

Gjykata Themelore në Prizren ka të caktuar një bashkëpunëtore profesionale si referente për ndërmjetësim dhe një zyrtar që është i angazhuar nga USAID, ndihmon për trajtimin e rasteve të referuar në ndërmjetësim. Në gjykatë ka një zyre të veçantë për trajtimin e rasteve për ndërmjetësim.

*4. Ekzekutimi i dënimeve në procedurën civile dhe penale;*

Gjendja me ekzekutimin e vendimeve qëndron si vijon:

**Gjykata Themelore Prizren**

EDGJ (ekzekutime të dënimeve me gjobë) janë pranuar 128 lëndë për ekzekutim, janë kryer 172 lëndë, ndërsa 215 lëndë janë në procedurë të ekzekutimit.

PED (ekzekutime të dënimeve me burg) janë pranuar 13 lëndë, janë ekzekutuar 28 lëndë, si dhe 67 lëndë të mbetura në procedurë të ekzekutimit ku janë ndërmarr të gjitha veprimet nga ana e gjykatës.

CP (shpenzime të paushallit gjyqësor) janë pranuar 204 lëndë, ndërsa janë kryer 339 lëndë.

Ekzekutime të kundërvajtjes janë pranuar 191 lëndë, janë ekzekutuar 167 lëndë, janë parashkruar 38 lëndë, ndërsa lëndët e pazgjidhura në fund të tremujorit të tretë janë 1002 lëndë.

**Gjykata Themelore – Dega në Suharekë**

PED (ekzekutime të dënimeve me burg) të ardhura 5 lëndë, të ekzekutuara 2 lëndë, si dhe 13 lëdnë të mbetura ne procedurë të ekzekutimit.

CP (shpenzime të paushallit gjyqësor) janë pranuar 21 lëndë, janë ekzekutuar 50 lëndë, ndërsa 1962 lëndë janë në procedurë të ekzekutimit.

Ekzekutime të kundërvajtjes janë pranuar 169 lëndë, 118 lëndë janë ekzekutuar, ndërsa 346 lëndë të mbetura ne procedurë të ekzekutimit.

**Gjykata Themelore Prizren – Dega në Dragash**

EDGJ (ekzekutime të dënimeve me gjobë) nuk është pranuar asnjë lëndë, është kryer vetëm 1 lëndë, ndërsa 55 lëndë janë në procedurë të ekzekutimit.

PED (ekzekutime të dënimeve me burg) është pranuar vetëm 1 lëndë, nuk është kryer asnjë, ndërsa në procedurë të ekzekutimit janë gjithsej 5 lëndë.

CP (shpenzime të paushallit gjyqësor) janë pranuar 2 lëndë, ndërsa janë kryer 5 lëndë si dhe 861 lëndë të mbetura ne procedurë të ekzekutimit.

Sa i përket ekzekutimit të lëndëve të kundërvajtjes, nuk ka lëndë të pranuara në këtë tremujor dhe nuk ka as lëndë të kryera, pasi që palët nuk janë përgjigjur ftesave të gjykatës dhe nuk ka mënyrë tjetër për ekzekutimin e tyre,

***5. Trajtimi i rasteve të shënjestruara***

Në Gjykatën Themelore në Prizren, është në punë një rast (SHKOLLA), për një pikë të aktakuzës për një të akuzuar (në fillim kanë qenë 3 të akuzuar për disa pika të aktakuzës).

Kjo lëndë nga Departamenti për Krime të Rënda, është bartur në Departamentin e Përgjithshëm për shkak të kompetencës sa i përket natyrës së veprës penale për të cilën rasti është kthyer në rivendosje.

Ashtu që në vitin 2023 kemi një rast aktiv i shënjestruar me shenjën “LV”.

***6. Çështja e seancave të shtyra dhe arsyet e shtyrjes***

Në të gjitha takimet me gjyqtarët e divizioneve dhe kolegjiumet, në vazhdimësi kemi diskutuar për të evituar sa më shumë seanca jo produktive. Pra, gjyqtarët kanë kujdes maksimal që të njoftohen të gjitha palët në rast të dështimit të seancave me kohë, ashtu që edhe përmes e-mailit zyrtar të gjykatës në vazhdimësi kemi komunikime me palë, avokatë dhe institucione të tjera të përfshira në procedurë, në rast kur dihet paraprakisht se do të dështon një seancë.

Nga Departamenti për Krime të Rënda kemi kërkuar që të ketë caktim të seancave të njëpasnjëshme dhe kjo është duke u praktikuar ashtu që për një rast caktohen 2-3 ditë seanca.

Dhe është kërkuar kujdes i veçantë në caktimin e seancave në rastet që janë në fokus të Planeve Strategjike dhe rasteve me interes të lartë.

Gjithashtu iu është tërhequr vërejtja gjyqtarëve për kujdes në caktimin e seancave dhe përmbajtjen e orarit sipas fletore së punës, ashtu që të mos ketë anulim dhe dështim të seancave si arsye e mungesës së gjyqtarëve apo anëtarëve të trupit gjykues për mos koordinim si dhe caktimi i seancave sipas smil-it dhe publikimi i tyre në tabelë informuese të gjykatës.

**Këto janë të dhënat të përpunuara nga sistemi SMIL për shtyerje/anulim të seancave**

**Gjykata Themelore Prizren**

Sa i përket shtyrjes së seancave në bazë të të dhënave të siguruara nga sistemi SMIL **në Departamentin për Krime të Rënda**, në tremujorin e III-të, janë shtyrë vetëm 5 seanca, më saktësisht 4 shtyrje e seancës sipas detyrës zyrtare dhe 1 mungesa e prokurorit.

**Në Departamentin për të Mitur**, në tremujorin e III-të, janë shtyrë 33 seanca gjyqësore, 26 si shkak i mungesës së të pandehurit, 2 sipas detyrës zyrtare dhe seanca tjera për arsye të tjera.

**Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal**, në tremujorin III-të, janë shtyrë 222 seanca, më saktësisht 158 mungesa e të pandehurit, 16 mungesa e dëshmitarit, ndërsa 27 sipas detyrës zyrtare dhe pjesa tjetër me kërkesë të palëve në procedurë (pandehurit, mbrojtësit apo prokurorit).

Në këtë tremujor ka pasur rritje të seancave të shtyera/anuluara në krahasim me tremujorin e I-rë dhe të II-të, të vitit 2023.

**Në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil**, në tremujorin e III-të, janë shtyrë gjithsej 33 seanca, asnjë seancë nuk është shtyer sipas detyrës zyrtare, por pengesa të tjera, apo me kërkesë të palëve në procedurë.

**Gjykata Themelore Prizren – Dega Suharekë**

**Në Divizionin Penal** në tremujorin e III-të, janë shtyrë 49 seanca. Më saktësisht 33 seanca për shkak të mos paraqitjes së të pandehurit, vetëm 1 sipas detyrës zyrtare dhe të tjera për pengesa apo arsye tjera.

**Në Divizionin Civil** në tremujorin e III-të, janë shtyrë vetëm 17 seanca.

**Gjykata Themelore Prizren – Dega Dragash**

**Në Divizionin Penal** në tremujorin e III-të, janë shtyrë 16 seanca gjyqësore, 12 si shkak i mungesës së të pandehurit, asnjë seancë nuk ka dështuar sipas detyrës zyrtare..

**Në Divizionin Civil** në tremujorin e III-të, janë shtyrë 5 seanca.

Në Divizionin Penal shumica e seancave shtyhen për shkak të mungesës së palëve në procedurë, apo dëshmitarëve. Një numër më i vogël me kërkesë të palëve në procedurë.

Ndërsa në Divizionin Civil rreth 80% e seancave shtyhen për shkak të mungesës së palëve apo me kërkesë të palëve ndërgjyqëse.

Këto statistika janë marrë nga Sistemi SMIL i cili i përpunon të gjitha shënimet të cilat gjyqtarët dhe zyrtaret që punojnë me gjyqtarë i evidentojnë në këtë sistem.

**Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren**

**Shpresa EMRA**

Gjykata Themelore

**PRIZREN**

| Sipas referencës: | |
|---|---|
| GjA. nr. | I.Gja.nr.1/2023-67 |
| Të datës: | 13.10.2023 |

**KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS**

**R A P O R T**

për punët e kryera

| Periudhat raportuese | | |
|---|---|---|
| Të vitit | Kohët e vitit | |
| 2023 | Çereku I. | |
| | Çereku II. | |
| | Çereku III. | 2023 |
| | Çereku IV. | |
| Tërësisht për vitin | | |

I. Nga menaxhimi i përgjithshëm:

1.

| 1. Juridiksioni i gjykatës | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Është gjykatë themelore e rajonit të | PRIZRENIT | me Komunat rrethuese | | | | | |
| Kjo gjykatë themelore | | | | Sipas degëve të veta, të cilat | | | |
| Funksionon në qytetin e: | Vendos sipas departamenteve: | | | Funksionojnë në: | | Vendosin sipas departamentit nr.5: | |
| | 1. Krime të rënda | | | | | | |
| | 2. Për të mitur | | | | | | |
| | 3. I përgjithshëm sipas divizioneve: | Penal | | 1 | SUHAREKË | 5. I përgjithshëm sipas divizioneve: | Penal |
| | | Civil | | 2 | DRAGASH | | Civil |
| | | Kundervajtje | | 3 | | | Kundervajtje |
| | | Egzekutime | | 4 | | | Egzekutime |
| Komenti: | | | | | | | |

2.

**2. Numri dhe struktura e të punësuarve**

2.1 Numri i gjyqtarëve sipas angazhimit në punë, paraqitur strukturën gjinore dhe përkatësinë nacionale:

| Gjykata themelore + Degët e gjykatës | | | | | | Aprovuara | | 0 | | Plotësuara | | 35 | | Lira | -35 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | | Serb | | Boshnjak | | Turq | | Goran | | Ashkalinj | | Rom | | Gjithësej | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 20 | 11 | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 22 | 13 |
| 31 | | 0 | | 3 | | 0 | | 0 | | 0 | | 1 | | 35 | |

| Gjykata themelore | | | | PRIZREN | | Aprovuara | | | | Plotësuara | | 28 | | Lira | -28 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | | Serb | | Boshnjak | | Turq | | Goran | | Ashkalinj | | Rom | | Gjithësej | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 15 | 9 | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 17 | 11 |
| 24 | | 0 | | 3 | | 0 | | 0 | | 0 | | 1 | | 28 | |

| Dega gjyqësore në | | | | SUHAREKË | | Aprovuara | | | | Plotësuara | | 5 | | Lira | -5 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | | Serb | | Boshnjak | | Turq | | Goran | | Ashkalinj | | Rom | | Gjithësej | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 4 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 1 |
| 5 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 5 | |

| Dega gjyqësore në | | | | DRAGASH | | Aprovuara | | | | Plotësuara | | 2 | | Lira | -2 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | | Serb | | Boshnjak | | Turq | | Goran | | Ashkalinj | | Rom | | Gjithësej | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 2 | |

| Dega gjyqësore në | | | | | | Aprovuara | | | | Plotësuara | | 0 | | Lira | 0 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | | Serb | | Boshnjak | | Turq | | Goran | | Ashkalinj | | Rom | | Gjithësej | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | |

| Dega gjyqësore në | | | | | | Aprovuara | | | | Plotësuara | | 0 | | Lira | 0 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | | Serb | | Boshnjak | | Turq | | Goran | | Ashkalinj | | Rom | | Gjithësej | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

**2. Numri dhe struktura e të punësuarve**

2.2 Numri i stafit ndihmës të angazhuar në punë, paraqitur strukturën gjinore dhe përkatësinë nacionale:

| Gjykata themelore + Degët e gjykatës | | | | | | Aprovuara | | 0 | | Plotësuara | | 160 | | Lira | -160 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | | Serb | | Boshnjak | | Turq | | Goran | | Ashkalinj | | Rom | | Gjithësej | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 66 | 72 | 0 | 0 | 1 | 5 | 3 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 5 | 73 | 87 |
| 138 | | 0 | | 6 | | 6 | | 0 | | 0 | | 6 | | 160 | |

| Gjykata themelore | | | | PRIZREN | | Aprovuara | | | | Plotësuara | | 109 | | Lira | -109 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | | Serb | | Boshnjak | | Turq | | Goran | | Ashkalinj | | Rom | | Gjithësej | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 38 | 53 | 0 | 0 | 1 | 5 | 3 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 5 | 43 | 66 |
| 91 | | 0 | | 6 | | 6 | | 0 | | 0 | | 6 | | 109 | |

| Dega gjyqësore në | | | | SUHAREKË | | Aprovuara | | | | Plotësuara | | 29 | | Lira | -29 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | | Serb | | Boshnjak | | Turq | | Goran | | Ashkalinj | | Rom | | Gjithësej | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 11 | 18 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 11 | 18 |
| 29 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 29 | |

| Dega gjyqësore në | | | | DRAGASH | | Aprovuara | | | | Plotësuara | | 22 | | Lira | -22 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | | Serb | | Boshnjak | | Turq | | Goran | | Ashkalinj | | Rom | | Gjithësej | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 17 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 19 | 3 |
| 18 | | 0 | | 0 | | 0 | | 4 | | 0 | | 0 | | 22 | |

| Dega gjyqësore në | | | | | | Aprovuara | | | | Plotësuara | | 0 | | Lira | 0 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | | Serb | | Boshnjak | | Turq | | Goran | | Ashkalinj | | Rom | | Gjithësej | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | |

| Dega gjyqësore në | | | | | | Aprovuara | | | | Plotësuara | | 0 | | Lira | 0 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shqiptar | | Serb | | Boshnjak | | Turq | | Goran | | Ashkalinj | | Rom | | Gjithësej | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | |

| | |
|---|---|
| Komenti: | |

3.

2. Gjendja aktuale me aktivitete te burimeve njerezore

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës

1. Shfrytëzimi i pushimeve

| Për të punësuarit në Gjykatë | Me pagesë | | | | Pa pagesë | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Vjetor | Mjekësor | Lehonie | Përdëllimit | Ngritje profesionale | Kujdes familjar | Tjetër |
| Gjyqtar | | | | | | | |
| Nëpunës | | | | | | | |
| Total: | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Komenti: | | | | | | | |

2. Procedurat e rekrutimit:

| Për të punësuarit në Gjykatë | Te shpallura: | | | Lloji i kontrates | | Rezultati i konkurseve | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Konkurse te jashtme | Konkurse te brendshme | Nr. i kandidateve konkurues | Karrieres / Jo karrieres | Punes | Pozitiv | Negativ |
| Gjyqtar | | | | | | | |
| Nëpunës | | | | | | | |
| Total: | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Komenti: | | | | | | | |

3. Disiplinimi:

| Për të punësuarit në Gjykatë | Disiplinimi | Komisioni i brendshem | | Shkalla e dyte | | Lloji i masës | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Numri i Disiplinimeve | Disiplinuar | Liruar | Disiplinuar | Liruar | Mase e lehte disiplinore | Mase e rende disiplinore |
| Gjyqtar | | | | | | | |
| Nëpunës | | | | | | | |
| Total: | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Komenti: | | | | | | | |

4. Ankesat në përgjithësi:

| Për të punësuarit në Gjykatë | Ankimimet | | | Komisioni i brendshem | | Shkalla e dyte | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Numri i ankesave | Ankese per rekrutim | Ankese tjeter | Miratuar | Refuzuar | Miratuar | Refuzuar |
| Gjyqtar | | | | | | | |
| Nëpunës | | | | | | | |
| Total: | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | |
|---|---|
| Komenti: | |

4.

| 4. Hyrje/daljet financiare | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës | | | | | |
| | 1. Për programin e buxhetuar të gjykatës për vitin 2022, shprehur në Euro valutë: | | | | | |
| | Periudha: | Destinacioni i parasë: | | Të buxhetuara: | Të shpenzuara: | Të pa shpenzuara: |
| | Çereku: I./2023 | a. | Paga dhe mëditje | | | |
| | | b. | Mallra dhe shërbime | 72,000.00 € | 29,997.35 € | 42,002.65 € |
| | | c. | Shpenzime komunale | 12,900.00 € | 3,380.00 € | 9,520.00 € |
| | | d. | Investime kapitale | | | |
| | | Në përgjithësi: | | 84,900.00 € | 33,377.35 € | 51,522.65 € |
| | Komenti: | | | | | |
| | Periudha: | Destinacioni i parasë: | | Të buxhetuara: | Të shpenzuara: | Të pa shpenzuara: |
| | Çereku: II./2023 | a. | Paga dhe mëditje | | | |
| | | b. | Mallra dhe shërbime | 67,000.00 € | 113,655.29 € | (46,655.29) € |
| | | c. | Shpenzime komunale | 9,300.00 € | 14,586.23 € | (5,286.23) € |
| | | d. | Investime kapitale | | | |
| | | Në përgjithësi: | | 76,300.00 € | 128,241.52 € | |
| | Komenti: | | | | | |
| | Periudha: | Destinacioni i parasë: | | Të buxhetuara: | Të shpenzuara: | Të pa shpenzuara: |
| | Çereku: III./2023 | a. | Paga dhe mëditje | | | - € |
| | | b. | Mallra dhe shërbime | 50,000.00 € | 50,556.38 € | (556.38) € |
| | | c. | Shpenzime komunale | 9,000.00 € | 8,849.83 € | 150.17 € |
| | | d. | Investime kapitale | | | |
| | | Në përgjithësi: | | 59,000.00 € | 59,406.21 € | (406.21) € |
| | Komenti: | | | | | |
| | Periudha: | Destinacioni i parasë: | | Të buxhetuara: | Të shpenzuara: | Të pa shpenzuara: |
| | Çereku: IV./2023 | a. | Paga dhe mëditje | | | - € |
| | | b. | Mallra dhe shërbime | | | - € |
| | | c. | Shpenzime komunale | | | - € |
| | | d. | Investime kapitale | | | - € |
| | | Në përgjithësi: | | - € | - € | - € |
| | Komenti: | | | | | |
| | Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës | | | | | |
| | 2.1. Të hyrat në buxhetin e Kosovës | | | | | |

| Nga periudhat: | Të inkasuara në Euro valutë, sipas bazës paguese | | | | | Gjithësej |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Taksë | Dënim | Paushall | komp.viktim | Konfiskim | |
| I./2023 | 135,064.10 € | 199,873.00 € | | 15,860.00 € | | 350,797.10 € |
| II./2023 | 96,103.36 € | 124,559.00 € | | 6,890.00 € | | 227,552.36 € |
| III./2023 | 108,125.91 € | 178,257.00 € | | 8,630.00 € | | 295,012.91 € |
| IV./2023 | | | | | | - € |
| Gjithësej: | 339,293.37 € | 502,689.00 € | - € | 31,380.00 € | | 873,362.37 € |
| Komenti: | | | | | | |

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës

2.2. Për të hyrat në Thesarin (Trezorin) e Kosovës

| Nga periudhat: | Të inkasuara në Euro valutë, sipas bazës paguese | | | | | Gjithësej |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Garancion për kontest | Depozitim (pignus) gjyqësor | Corpus delicte | Parapagim për shpenzime | Për raste tjera | |
| I./2023 | | 28,403.00 € | | | | 28,403.00 € |
| II./2023 | | 29,923.19 € | | | | 29,923.19 € |
| III./2023 | | 34,414.00 € | | | | 34,414.00 € |
| IV./2023 | | | | | | - € |
| Gjithësej: | | 92,740.19 € | | | | 92,740.19 € |
| Komenti: | | | | | | |

5.

| | |
|---|---|
| 5. Çështje Logjistike | |

6.

| | Numri i prokurimit publik | Lloji i kërkesës | Shuma | Realizimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | po | jo |
| 6. Prokurimi Publik | | | - € | 0 | 0 |
| | | | - € | 0 | 0 |
| | | | - € | 0 | 0 |
| | | | - € | 0 | 0 |
| | | | - € | 0 | 0 |
| | E përgjithshme prej: 01.01.2020-31.12.2020 | | - € | 0 | 0 |

7.

| | | |
|---|---|---|
| | 1. Numri i projektit | |
| | 2. Emërtimi i projektit: | |

| | | |
|---|---|---|
| 7. Projektet e realizuara | 3. Partenerët e projektit: | |
| | 4. Vlera e projektit: | |
| | 5. Të involvuarit në projekt: | |
| | 6. Kostoja e projektit: | |
| | 7. Rezultatet e projektit: | |
| | Komenti: | |

**8.**

| | |
|---|---|
| 8.Identifikimi i pengesave në punët për vendimarrje lidhur me paqartësi ligjore në zbatim | Në lidhje me indentifikimin e pengesave për vendimmarrje dhe paqartësi në zbatim duhet të cekim se sa i përket numrit të stafit mbështetës me dorëzues dhe zyrtar të arkivës nuk jemi plotësuar në numër të mjaftueshëm dhe duke pasur parasysh se disa zyrtarë , respektivisht një referent dhe një vozitës janë pensionuar dhe në përgjithësi vendet e tyre të punës ende nuk janë plotësuar në numër të duhur konsiderojmë se mosplotësimi i këtyre vendeve të punës paraqesin pengesë në realizimin e detyrave të punës dhe objektivave . Për paqartësi ligjore në zbatim nuk kemi ndonjë vërejtje të veqantë. |

**9.**

| | |
|---|---|
| 9. Mbledhjet e mbajtura lidhur me menaxhimin e gjykatës dhe lëndëve gjyqësore | Kryetarja e gjykatës dhe administratorja kanë mbajtur takime të rregullta si me gjyqtarë të secilit Departament dhe Divizion në lidhje me Strategjinë e KGJK -së dhe programin e paraparë për tejkalim të problemeve ashtu edhe me stafin administrativ të secilit Departament. Janë përcaktuar detyrat konkrete për zbatim në lidhje me strategjinë për gjyqtarët dhe janë caktuar afatet konrete për kryerjen e këtyre detyrave Gjithashtu është mbajtur mbledhje e veqantë me bashkëpunëtorët profesional për punën e organizimit të mbështetjes së punës së gjyqtarve në tërësi si dhe kryerjes së punëve të tyre në veqanti.Me administratoren e gjykatës kryetarja ka mbajtur mbledhjen me stafin adminstrativ ku edhe janë kryer disa ndryshime në organizim duke planifikuar mbështetjen e punës së gjyqtarëve me stafin administrativ dhe rrjedhën e punës pa probleme . |

**10.**

| | |
|---|---|
| 10. Identifikimi i pengesave në punë dhe propozimi i masave për tejkalimin e tyre | Pengesat në punë janë paraqitur si më lartë sepse gjatë këtij tremujori kemi pasur mungesë të stafit mbështetës, si referentë dhe zyrtarë ligjor ,por të cilët në ndërkohë kah fundi i këtij tremujori janë plotësuar këto vende vakante dhe janë eliminuar pengesat rreth punës me stafin mbështetës.Gjithashtu duke pasur parasysh se kemi qenë në periudhën e pushimeve vjetore kemi bërë riorganizim dhe planifikim e punës së gjyqtarëve dhe të stafit mbështetës me qëllim të mos ndikojë në ndalimin e kryerjes së obligimeve të punës dhe mbajtjes së rregullt të gjykimeve. Në këtë drejtim nuk kemi pasur kurfarë problemi edhepse kemi pasur numrin e kufizuar të stafit mbështetës. Propozojmë që të plotësohen vendet e kërkuara të stafit mbështetës duke pasur parasysh se kemi ndryshim të gjendjes në avansim të personelit të gjykatës. |

**11.**

| | |
|---|---|
| 11. Bashkëpunimi i gjykatës me subjektët jo gjyqësor kombëtar dhe ndërkombëtar. | Gjykata ka bashkëpunim të mirëfilltë me organizatata ndërkombëtare si OSCE dhe USAID , kurse me subjekte jogjyqësore ka bashkëpunim me Komunën e Prizrenit, Strehimoren , mbrojtësit të viktimave , ka gadishmëri që të bashkëpunojë me secilin subjekt jo gjyqësor në suaza profesionale dhe në raste kur nuk ndikon në punën e tërësishme të gjykatës. Bashkëpunim të veqantë gjykata ka me Prokurori dhe Polici . Duhet të cekim se bashkëpunimi është i vazhdueshëm , por se gjatë këtij tremujori për shkak të pushimeve ka qenë me intensitet më të vogël dhe i kufizuar në disa takime. |

12.

| | |
|---|---|
| 12. E rëndësisë së veçantë për paraqitje në KGJK | Me funksionalizimin e objektit të ri janë paraqitur shpenzime të shtuara në mbështeje të punës së gjyqtarëve të cilët janë vendosur në këtë objekt të cilët janë 10 gjyqtarë të lëmisë civile dhe të cilët kanë nevojë për asistim në dalje në teren, në dorëuim të ftesave dhe të shkresave tjera nga ky objekt në objektin e vjetër andaj propozojmë që të shqyrtohet mundësia e angazhimit të një vozitësi ( i cili është pensionuar), një recepcionisti, një arkivisti ( në mungesë të arkivistit të lartë) dhe një mirëmbajtësi pasi që tani kemi dy objekte të Gjykatës kurse këto vende të punës janë mbështetur vetëm me nga një punëtor. |

## II. Treguesit statistikor për lëndët gjyqësore:

## III. Përmbyllja

1

| | |
|---|---|
| Rekomandime për KGJK | Rekomandimet për KGJK-në janë : Të plotësohen vendet e lira të punës së stafit adminstrativ; të bëhet gëlqerosja e objektit të vjetër gjykatës ; të përfundojë procedura e asgjësimit të lëndëvë të kundërvajtjes ; të ndihmohet në mirëmbajtje të arhivave dhe të modernizohen të njejtat me ndonjë sistem mbështetës të arkivimit dhe në tërësi të bëhet mbështetja e punëve rreth stafit adminstrativ gjithashtu të sigurohet hapësira për arkivim të lëndëve të kryera pasi që të gjitha hapsirat janë të stërmbushura, gjithashtu kemi edhe një sasi të kosiderueshme të arhivës të një notere nga Mamusha të pranuar më herët. |

2

| | |
|---|---|
| Përfundim përmbledhës | Fillimisht falenderoj KGJK-në për përkrahjen në finalizimin e objektit të ri të gjykatës dhe plotësimin e vendeve të punës për bashkëpunëtor profesional, për referentë dhe për zyrtarë ligjor. Si përfundim mund të cekim se e gjithë puna e gjykatës duhet të jetë në koordinim me KGJK-në në mënyre që të zbatohet Strategjia e aprovuar si dhe të realizohen objektivat e strategjisë. |

**Kryetarja e gjykatës**

_______________________